



## KËSHILLA RRETH INFEKSIONEVE QË BARTEN NË RRUGË SEKSUALE

DET HËR ËR EN ÖVERSÄTTNING TILL ALBANSKA AV FAKTABLADET RÅD OCH FAKTA OM SEXUELLT ÖVERFÖRDA INFEKTIONER - HIV.

# Hiv-i

Infeksioni i hiv ose Hiv-i siq quhte ndryshe kjo sëmundje shkaktohet nga një virus dhe hiv-i është shkurtesa; virusi i mungesës së imunitetit te njeriu. Hiv-i bartet nga seksi i pambrojtur vaginal dhe anal. Virus mund të bartet edhe gjatë seksit oral nëse e merr spermën në gojë dhe mukoza e gojës është e lënduar. Ti mund të infektosh me hiv, nëse përdor drogë dhe i ndanë shiringat dhe gjilpërat me dikë që e ka këtë virus.

### Simptomet e hiv-it

Nuk është e nevojshme që në fillim të ndjesh ndonjë simptomë nëse ke marr hiv-in. Dikush ka dhimbje fyti, temperaturë apo gjëndra limfatike të ënjtura e nganjëherë puçrra në trup. Simptomet shfaqen afërsisht nga një deri në katër javë pas momentit të infektimit. Ky quhet infeksion primar. Simptomet u ngjasojnë atyre të gripit dhe zhduken pas ndonjë jave. Ndërkohë që infeksioni vazhdon në heshtje të dobësor sistemin e imunitetit. Ngjithshmëria është ekstra më e amdhe gjatë muajve të parë nga momenti i infektimit. Sasia e virusëve është shumë e amdhe në fillim, para se sistemi imun të arrij të reagoj, pavarësisht a të shfaqen simptomet apo jo.

### Testohu për hiv-in

Testimi për hiv është falas sepse hiv-i përfshihet nga ligji për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse. Testimi bëhet përmes analizës së gjakut dhe mund të bëhet në mënyrë anonime nëse do ti. Nëse dyshon se e ke hiv-in duhet të testohesh për të pasur çasje në ndihmën medicinale dhe për të marrë përkrahje dhe njohuri rreth infeksionit në mënyrë që të mos e përhapësh infeksionin e hiv-it tek të tjerët.

Të testuarit është mënyra e vetme për të konstatuar sakt statusin tuaj të hiv-it. Testi, varësisht nga lloji i testit, ka mundësi të zbuloj këtë infeksion në gjak më së herëti afërsisht dy javë e më së voni gjashtë deri në tetë javë pas kohës kur je infektuar. Nëse dyshon se je infektuar me hiv-in është me rëndësi që sa më parë që është e mundur të kontaktosh organet shëndetësore për këshillmarrje dhe testim. Njësinë më të afërt pranuese e gjen, [www.1177.se](http://www.1177.se). Për të marrë një përgjigje plotësisht të sigurt ti rekomando-hesh që të testohesh sërish pas gjashtë deri në tetë javë pas

kohës kur ti dyshon de je infektuar me virusin, kuptohet nëse testimin e parë e ke bërë pas një kohe më shkurtur. Nëse testimi tregon se ti e ke hiv-in atëherë duhet që edhe partnerët tuaj seksual të testohen.

### Mjekimi

Nuk ka ndonjë vaksinë mbrojtëse ose ilaç shërues kundër hivi-t. Por tani ka ilaçe efektive të cilat e frenojnë përparimin e sëmundjes dhe bëjnë që sistemi i yt imun të mos shkatërrohet, nëse fillohet në kohë me ilaçe. Dhe me këtë pengohet që sëmundja e rëndë mungesës së imunitetit (aids, nga anglishtja Acquired Immune Deficiency Syndrome) të zhvillohet.

Poashtu një terapi funksionale me ilaçe mund të bëjë që ngjithshmëria të jetë e ulët, pasi që sasi e virusëve në gjak dhe lëngje tjera të trupit zvogëlohet dukshëm. Kjo vlen nëse nuk ke ndonjë sëmundje tjetër veneriane. Andaj duhet përdorur kondom gjithmonë në rast seksi për të minimizuar rrezikun e infektimit dhe për t'i mbrojtur të tjerët nga sëmundjet gjinitale.

Meqenëse terapia nuk është shëruese duhet që kjo të vazhdoj tërë jetën. Terapia bëhet përmes kombinimit të tri llojeve të ilaçeve dhe ato mund të shkaktojnë efekte anësore që mund ta keqësojnë kualitetin e jetës. Por sot ka një numër të madh të ilaçeve dhe mund të gjendet një kombinim i cili shkakton më së paku efekte negative. Nëse fillohet terapia me kohë atëherë supozohet se njeriu mund të jetojë një jetë të gjatë sikurse do kish jetuar pa hiv.

### Të mendosh rreth hiv-it

Mbrojtja më mirë nga infektimi me hiv është që të praktikohet seksi i sigurt me kondom me rastin e marrëdhënieve seksuale si dhe ikja e kontaktit me mukoza me gjak dhe lëngjeve tjera trupore që mund të përmbajnë virusin.

Nëse ke ndonjë sëmundje tjetër veneriane, mundesh që më lehtë të infektosh me hiv nëse ke seks të pambrojtur me ndonjë partner që e ka hiv-in. Nëse e di se ke qënë në kontakt me hivi-n, ditët e fundit, kontaktoje menjëherë klinikën infektive aty ku banon për të bërë vlerësimin se a është e mundur të jepet terapia preventive (postexposition-sprofylax – PEP) kundër hiv-it për të penguar që infeksioni të fiksohet në trup.


Infeksioni i hivi-t nuk do të thotë që ti automatikisht e ke apo do t'a marrësh sidën/aids-in.

Nëse nuk fillohet me terapi atëheri hiv-i i asgjëson rruazat e bardha të gjakut që janë të rëndësishme për

imunitetin. Kur imuniteti të jetë dobësuar dukshëm atëherë mund të fitosh sëmundje tjera pasuese. Këto sëmundje mund të jenë të rrezikshme për jetë dhe quhen me një emër të përbashkët sidë/aids. Në këtë fazë numri i virusëve është shtuar dhe ngjithshmëria është e lartë.

Për të penguar zhvillimin e sidës është me rëndësi që të fillohet terapia para se imuniteti i yt të jetë dëmtuar shumë. Andaj është e rëndësishme që të mos vonohesh me testim nëse dyshon se ke qenë i eksponuar rrezikut të hiv-it. Fatëkeqësisht në Suedia akoma ka shumë persona që e marrin diagnozën vonë dhe imuniteti i tyre ka arritur të dëmtohet seriozisht.

Të gjitha femrave shtatëzëne u ofrohet testim hiv-i në mënyrë që të fillohet me tarpi hiv-i gjatë shtatëzënisë dhe mund të merren masa kujdesi në mënyrë që gjatë lindjes të zvogëlohe rreziku nëse nëna e ka hiv-in. Andaj sot është shumë e pazakonshme që në Suedi një nënë me hiv t'ia ngjet virusin fëmijës gjatë shtatëzënisë apo lindjes.



Folkhälsomyndigheten  
PUBLIC HEALTH AGENCY OF SWEDEN

Solna Nobels väg 18, 171 82 Solna Östersund Forskarens väg 3, 831 40 Östersund.  
[www.folkhalsomyndigheten.se](http://www.folkhalsomyndigheten.se)